



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni Vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr. 71/2012  
Prishtinë, më 22.08.2012, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,**  
**TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Dëshishku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

**Munguan :** Fikrim Damka, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi dhe Visar Ymeri.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Ukë Gashi - ZPRK; Dita Dobranja –INDEP; Haxhi Gashi –USAID/Delotte.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.07.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme;
4. Te ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.07.2012**

*Procesverbali nga mbledhja e datës 10 .07.2012 u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme**

**Kryetari** – Hapi debat në parim në lidhje me këtë Projektligj të proceduar nga Qeveria dhe propozoi që të formohet një grup i punës, ashtu siç është e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, që ky grup i punës ta shqyrtojë Projektligjin nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, dhe pastaj që t'i nxjerrin propozimamendamentet për shqyrtim në mbledhje të Komisionit.

*Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë*

#### *P ë r f u n d i m*

*Miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër, për sendet e luajtshme.*

*Kuvendit vendosi që t'ia paraqet këtë*

#### *R e k o m a n d i m*

*Të miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër, për sendet e luajtshme.*

*Po ashtu, Komisioni unanimisht nxori këtë*

#### **V E N D I M**

- 1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër, për sendet e luajtshme.*
- 2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Myzejene Selmani raportuese, Teuta Sahatqija dhe Biserka Kostiq- anëtarë.*
- 3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.*
- 4. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raport me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

### **4. Të ndryshme**

#### **a) Organizimi i takimit të punës lidhur me planin e punës së Komisionit**

**Kryetari** - Kërkoj nga stafi mbështetës i Komisionit që shumë shpejt të organizojë një takim me shoqërinë civile dhe me partnerë të tjerë, që mbështesin punën e Komisionit, lidhur me Planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor.

***b) Projektligji nr. 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit***

**Hashim Deshishku** – Në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës për Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit, kërkoi që në mbledhjen radhës të hyjë në rendin e ditës shqyrtimi i propozimamendamenteve për këtë Projektligj, pasi që grupi i punës e ka përfunduar punën dhe u ka vënë në dispozicion raportin me amendamente.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:30.**

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Zenun Pajaziti**

-----  
**Kryetar i Komisionit**